



MESAZHI I MIRAXHIT...



E VËRTETA E ADHURIMIT



SECILI TË RREGULLOJË VETEN,
TË LUTET ... DHE TË MOS BËHET
PALË ME TË KEQEN!

Viti XV - Nr. 4 (170),
Prill, 2017

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



ZBULOHEK NJË DORËSHKRIM I RI NGA HAFIZ YMER BAKALLI



MATERIALI NË FJALË, KA NJË VLERË TË MADHE NË TRAJTIMIN E POZITËS SË SAHABËVE NË ISLAM DHE DISTANCIMIN NGA ETIKETIMET FANATIKE DHE INJORANTE NË HAK TË TYRE, ËSHTË SHKRUAR ME DORËN E HOXHËS SË DITUR NË FLETË TË BARDHA, ME STILOGRAF ME NGJYRË TË ZEZË, ËSHTË I QEPUR NË MES DHE KA DY KOPERTINA TË TRASHA ME ZBUKURIME ORIENTALE. DORËSHKRIMI ËSHTË NDARË NË DY TEMA, TË CILAT AUTORI I TRAJTON PARALELISHT, TË NDARA NGA NJËRA-TJETRA, BRENDA SECILËS FAQE. PRA, KEMI TË BËJME ME DY TRAJTESA RRETH NJË TEME, NË NJË DORËSHKRIM TË VETËM.



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

SECILI TË RREGULLOJË VETEN, TË LUTET PËR MIRËQENIEN DHE TË MOS BËHET PALË ME TË KEQEN!

Në ajetin e lartpërmendur, All-llahu i Madhëruar përmend tre kategori njerëzish, të cilët janë pjesë e këtij ymmeti të begatë islam: dëmtues i vetvetes (dhalimun linefsihi), mesatar (muktesid) dhe ata që me mbarësinë e All-llahut, janë të parët në punë të mira (sabikun bil-khajrat).

Në Islam nuk ka mashtrim! Muslimani nuk gënjen, muslimani nuk vjedh, muslimani nuk është njeri i korruptuar, muslimani nuk merr jetën e tjetrit, muslimani nuk terrorizon, muslimani nuk hedh baltë mbi të tjerët, muslimani nuk ia bën gropën vëllasë së tij musliman, muslimani nuk është pijetar, muslimani nuk është imoral!

Në Islam, ne jemi të ftuar të afrohem me Zotin tonë, në rrugëtimet e përsosmërisë individuale dhe asaj shoqërore. Kësisoj, muslimani është i pastër, muslimani pendohet nga gjynahu që bën për të mos iu kthyer më atij, muslimani lartësohet nëpërmjet namazit, dhikreve, leximit të Kur'anit, namazit të natës, tehexhudit, agjërit, umresë, haxhit, dhënies së zekatit, sadekave, ndihmës ndaj të vobektëve. Muslimani është simbol i paqes sociale dhe i krejt elementëve të së mirës në jetë!

E kundërta, nuk ka lidhje me fenë dhe me besimin tonë! Ajo që përhapet sot, nëpërmjet propagandave të së keqes në mbarë botën, kundër nesh, kundër Resulull-llahut (a.s), kundër Kur'anit, kundër Islamit, nuk është asgjë tjetër, vetëm se një periudhë dëshpërimi në zemrat e atyre që e kanë kuptuar se Islami është feja e këtij shekull dhe, se mbarë bota po ndërgjegjësohen dhe po zgjohen nga gjumërat e idhujtarive, paditurisë, mashtrimeve të mëdha dhe korrupsionit me zemrën dhe intelektin botëror!

TË DASHUR BESIMTARË,

Koha është që ta shfrytëzojmë këtë periudhë tremujore, duke bërë një kontroll të imët ndaj vetes; mendimeve, sjelljeve, veprave, mënyrës së komunikimit në familje, me prindërit, me fëmijët, me të afërmit, me shoqërinë, me vëllazërinë e xhamisë, me bashkëqytetarët. Koha është që gjithsecili prej nesh të deklarojë pendimin e tij para duarve të All-llahut,

duke kërkuar falje në sexhde, natën, teksa njerëzit flenë. Duke trokitur dyert e mëshirës, faljes, udhëzimit, rizkut, bujarisë, butësisë, dijes, urtisë, aty në sexhde, para duarve të All-llahut, që nuk ka nevojë as për faljen tonë, as për adhurimet e krejt universit!

VËLLEZËR DHE MOTRA,

Ju e shihni sesi vendi ynë, po rrëshqet ditë pas dite drejt gremineve të pasigurisë, të varfërisë e skamjes, krizave politike e korrupsionit, hashashit e drogës, islamofobisë dhe një anarshie të frikshme, para të cilave, e kemi për detyrë të mos heshtim dhe të marrim përgjegjësitë tona si qytetarë të këtij vendi!

Secili të rregullojë veten, të lutet për mirëqenien dhe të mos bëhet palë me të keqen! Sepse, kushdo që mbështet të keqen, do të japë llogari para duarve të Krijuesit në ditën e gjykimit!

Shihni qytetin tuaj! Shkodra nuk është kjo! Na e kanë kthyer qytetin në arenë vulgu, që gëlon gjithandej në rrjete sociale, në media, në institucione, për shkak të politikave tjetërsuese të shpirtit shekullor të qytetarisë shkodrane, të harmonisë komunitare, të bashkëjetesës në mesin e qytetarëve me fe të ndryshme, në mesin e tregtarëve, në sport, në kulturë, gjithandej!

Prandaj, të kthehemi nga Zoti, të kthehemi nga feja e jonë, të rregullojmë atë që është prishur dhe të mos tolerojmë, për asnjë arsye, tjetërsimin, sepse politikat e tjetërsimit, po bëjnë me fëmijët tanë dhe edukimin e tyre, atë që bënin dikur komunistët me ata breza, që sot konsiderohen si “breznë e djegur”!

Fëmijët tanë janë brezat e ardhmë të Islamit, të shekullit të Islamit, të pastërtisë së Islamit, të Shqipërisë së Islamit, të bashkëjetesës së pashembullt të drejtësisë, paqes dhe vlerave të Islamit! Për këtë të punojmë dhe për këtë të shfrytëzojmë këtë periudhë të madhnueshme, që sapo ka trokitur në dyert tona, si një mundësi që nuk duhet neglizhuar!

All-llahu ju dashtë e ju begatoftë me mirësitë e Tij!

(Hytbeja e mbajtur, më 31 mars 2017, në xhaminë e Parrucës)

THIRRJA E AMANETIT...

(Shënime të grumbulluara nga trashëgimia e hoxhallarëve të Shkodrës)

Me mbarësinë e All-llahut, plotësova këtë cikël të ri me shkrime e kujtime, gjurmë e këshilla, nga trashëgimia e pashpalosur e hoxhallarëve të nderuar të qytetit tim, gjurmët dritësuese të cilëve, më ftojnë dhe më thërrasin që të mos hesht dhe mos ta fsheh Amanetin e tyre, i cili rrezaton mirësi, dije, paqe e bekim mbi Shkodër e mbarë botën.

Zgjedha këtë cikël të ri me shënime mbi jetën dhe gjurmët e tyre, pikërisht në këtë kohë, si një sinjal i fshehur pas rreshtave, që dëshmon se gjurmët e të mëdhenjve rrezatojnë përherë drejt të Vërtetave të mëdha, teksa faraonët ngelen gjurmë e zezë e të kaluarave të hirta dhe skutave të errëta të shpirtave të humbur!

Hoxhallarët tanë, rahmeti i All-llahut i mbuloftë, ishin elitë, që punuan në heshtje, u përballën me lloj-lloj sprovash, duruan, triumfuan, emrat e tyre u skalitën në përjetësi, si mbrojtës të besimit dhe dijes, përhapës të moralit dhe vlerave, elitë e dinjitetit kombëtar dhe amaneteve shekullore, që njeriun e mësojnë dhe e edukojnë të jetojë si NJERI! - **Muhamed B. Sytari**

1 - VARGJE PËR LIBRIN...

I tha Es-Sejjid Esh-Sherif El-Xherxhani, Imam Teftazanit, në vargje: “Mos e ndalo librin që hua të kërkohet, Kopracia për njeriun turp është! As'e ke dëgjuar hadithin që transmetohet, Shpërblimi i kopracisë tek All-llahu, zjarr është!?”

Ia ktheu Imam Teftazani, po në vargje: “O ti kërkues i librave, lermë, Se huazimi i të dashurit, turp është! I dashuri im në këtë botë, libri është, Të jepet hua i dashuri, turp është!?”

2 - RRUGËT E VILAJETIT

“Besimtari arrin në gradën e vilajetit me një nga tre mënyrat e mëposhtme: me leximin e librave, me dashurinë në All-llah dhe me pasimin e një murshidi!”

3 - KATËR POROSI NGA KATËR LIBRA TË SHENJTË

[Kam përzgjedhur katër porosi nga katër libra të shenjtë: Nga Teurati: “Kush heshti, shpëtoi!” Nga Inxhili: “Kush u bind me atë që ka, u ngop!” Nga Zeburi: “Ai që la veten, shpëtoi nga të metat!” Nga Furkani (Kur'ani): “Ai që mbështetet tek All-llahu, Ai i mjafton!”]

4 - I DASHURI QË NUK FSHIHET...

Mbi faqen e brendshme të një libri në gjuhën arabe, kam gjetur të shkruar këto vargje, me shkrimin e të quajturit Hafiz Sulejmani, i biri i Muhamedit:

“Bukuria jote para syve të mi, kujtimi yt në gjuhën time, Dashuria jote në zemrën time. E, ku të fshihesh? I dashuri mund të fshihet nga sytë e trupi im, Por, nga zemra ime, asnjëherë i dashuri nuk fshihet!”

5 - FRIKA NGA VDEKJA...

Në një nga librat e bibliotekës së Hafiz Ibrahim Repishtit, kam gjetur të

shkruar në gjuhën arabe, me shkrimin dhe firmën e tij, këtë shënim: “E kam blerë me pak të holla dhe frikësohem nga vdekja kur të më vijë”.

6 - ARMIQËSIA NGA HASEDI

Kam gjetur të shkruar në gjuhën arabe, me shkrimin e Adem ef. Vehbiut, Myfti i Shkodrës, këtë shënim: “Çdo armiqësi mund të shpresohet shuarja e saj, përveç armiqësisë që lind nga hasedi (smira)”.

7 - SHËRIMI I AHMAKUT

Me shkrimin e Hirësisë së Tij, Adem ef. Vehbiut, në gjuhën arabe, kam gjetur edhe këtë shënim: “Ka thënë Isai alejhis-salam: Nuk pata vështirësi të ringjall të vdekurit, por isha i paafët të shëroj ahmakun!”

8 - DHIKRI ME KUR'AN

Me shkrimin e dorës së dijetarit të njohur shkodran Hafiz Sheuqet Boriçi, kam gjetur edhe këtë shënim në gjuhën arabe: “Ka thënë Imam Shatibiu (rahmet pastë): Atij që Kur'ani i zë gjuhën, do të arrijë të plotë shpërblimin e dhakirinëve!”

9 - DEGË TË NJË FAMILJEJE...

Me shkrimin e dorës së hoxhës shkodran Hafiz Myrteza Vuci, kam gjetur të shkruar edhe emrin e tij, në vargun e pemës së tij gjenealogjike, fenomen që e kam hasur edhe në shënimet e hoxhallarëve të tjerë të shkruar, si: H. Halid Bushati, H. Halil Puka, H. Muhamed Bektashi, H. Vehbi Gavoçi etj.

Në shënimet e H. Myrteza Vucit, është edhe ky varg emrash: “Myrtezai, i biri i Abdull-llahut, i biri i Mustafait, i biri i Hamzait, i biri i Bekër (Beqir) Vucit”.

10 - JASIN...

Me shkrimin e dorës së dijetarit shkodran Hafiz Adem Kazazi, kam gjetur

të shkruar besmelenë (bismil-lahirrr-rrahmanirrr-rahim) dhe ajetet e para të sures “Jasin”, shoqëruar me shënimin: “Posedues, Hafiz Adem Kazazi”.

11 - SHËNIM POSEDIMI...

Me shkrimin e dorës së Hafiz Halil Pukës, në gjuhën arabe, kam gjetur edhe këtë shënim posedimi të një prej librave të bibliotekës së tij: “Prej pasurive të të varfërit e të përlulurit, para Mbretit Fuqiplotë, Hafiz Halil, i biri i Molla Hysen Pukës. All-llahu ua faltë gjynahet dhe ua mbuloftë të metat. Amin, për hatrin e Zotërisë së të Dërguarve! Viti njëzet e një e treqind e njëmijë (1321) nga hixhreti i atij, që i është dhënë krenari e nder”.

12 - LIBËR, DORË MË DORË...

Prej shembujve shumë interesantë, të kalimit të një libri dorë më dorë, nga një hoxhë te një tjetër, është edhe rasti i mëposhtëm. Mbi një faqe të brendshme të grisur të një libri në gjuhën arabe kam gjetur këtë shënim: “Posedues i këtij libri, është Hafiz Alushi, i biri i Salih beg ulqinakut”.

Pak më tutje, një tjetër shënim, me dorën e Hafiz Muhamed Kastratit: “Ky libër ka kaluar nga dora e tij, në timen, me anë të blerjes, nga Hafiz Jusuf Këlmendi. Unë jam Hafiz Muhamed Kastrati”.

Për Hafiz Muhamed Kastratin, më pat folur gjerë e gjatë edhe i nderuari, H. Hamza Cungu, në një intervistë të gjatë, (të papublikuar), që pata zhvilluar me zotninë e tij në ambientet e fellores së Rusit, vite më parë.

13 - NGA HAFIZ ALUSH ULQINAKU...

Një tjetër shembull i ngjashëm me të lartpërmendurin, është edhe një shënim me dorën e Hafiz Alush Ulqinakut, që shënon: “E kam poseduar me anë të blerjes nga Hafiz Muharremi. Unë jam i varfëri, Hafiz Alushi, i biri i Salih

beg ulqinakut. I faltë të dy, Falësi i Madhëruar!”.

Më pas, shënimi me dorën e Hafiz Muhamed Kastratit: “E kam poseduar pas vdekjes së tij. Hafiz Muhamed Kastrati”.

14 - NË DORËN E DAUT EF. BORIÇIT...

Prej shembujve të shumtë të kalimit të një libri nga një shkollar te një tjetër, është edhe rasti kur Daut ef. Boriçi merr në posedim një libër nga një sheh kadiri.

Ja dhe shënimet e tyre mbi faqen e brendshme të librit në gjuhën arabe: “E posedoi, i varfëri, shërbëtori i të varfërve, Zotëri Sheh Osman Ruhi Kadiri. Zoti e faltë. Viti 1272 h.”

Më pas shënimi vijues: “Kaloi në posedim të të varfërit e të përlururit para Tij, Madhëruar qoftë, Davudi (Dauti), i biri i Mustafasë. Zoti i faltë të dy!” dhe vula e tij, që mban këtë shënim: “Daud Shukri”.

15 - VARGJET E TEFTAZANIT PËR LIBRIN...

Vargjet me të cilat Imam Teftazani i kthen përgjigje El-Xherxhanit, në të cilat thotë: “O ti kërkues i librave, lermë, – Se huazimi i të dashurit, turp është! – I dashuri im në këtë botë, libri është, – Të jepet hua i dashuri, turp është!”, i kam gjetur edhe në shënimet e dijetarit të shquar Hasan ef. Podgorica, prej të cilit ka marrë ixhazet Hafiz Halid beg Bushati, që ishte muxhizi i Hafiz Jusuf Këlmendit, ixhazetin e të cilit e kam evidentuar dhe përkthyer në shqip nga gjuha arabe.

Mbi faqen e brendshme të librit ku ndodhen të regjistruara këto vargje, gjendet edhe ky shënim: “Prej librave të dijetarit të nderuar (El-Alimul-Fadil) Hasan Efendi Podgorica”.

16 - SHËNIM I HAFIZ HALIL PUKËS...

Prej gjurmëveve të Hafiz Halil Pukës, mbi faqen e brendshme të një libri në gjuhën arabe, kam gjetur edhe shkrimin e tij, shoqëruar me vulën personale, në këtë shënim: “Posedues i këtij libri të dobishëm (është), Hafiz Halili, i biri i Molla Hysen Pukës. Zoti i faltë të dy! Viti gjashtëmbëdhjetë e treqind e njëmijë (1316) nga hixhreti i atij, që i është dhënë krenari e nder” dhe vula me këtë përmbajtje: “Hafiz Halil. 1316”.

17 - NUK KAM PARË SI KY ZULLUM...

Me shkrimin e dorës së Sheh Qazim Hoxhës, kam gjetur këto vargje, në gjuhën arabe: “Nuk kam parë padrejtësi më të madhe se padrejtësia ndaj nesh – Na bëjnë keq dhe urdhërohemi për mirënjohje”.



Mendoj se, në përmbajtjen e këtij shënimi, ka elementë të përbashkët me realitetet e sotme shqiptare!?

18 - I PËRLURURI PËR MËSHIRËN E ZOTIT TË TIJ...

Me shkrimin e dorës së Hafiz Jusuf Këlmendit, kam gjetur këtë shënim në gjuhën arabe, në një prej librave të bibliotekës së tij: “Prej librave të nevojtarit për mëshirën e Zotit të tij Fuqplotë, Hafiz Jusuf Këlmendi”.

19 - NË GJURMË TË DAUT EF. BORIÇIT...

Në kopertinën e brendshme të një libri në gjuhën arabe, kam gjetur disa shënime shumë interesante dhe tërheqëse, që mbajnë firmën e Daut ef. Boriçit.

Në shënimin e posedimit të librit në fjalë, shkruhet: “U rreshtua në rrjetin e posedimeve të mia, ndërsa unë jam i varfëri për të Vetmin, shkodrani, Boriçizade Daudi, i biri i Haxhi Mustafasë. I faltë të dy! Viti 260 h.” Vula.

20 - SHËNIM I HAFIZ HALID BUSHATIT...

Edhe Hafiz Halid Bushati ka pasur një mënyrë tjetër në nënshkrimin e librave të bibliotekës së tij.

Në një prej këtyre librave, kam gjetur këtë shënim në gjuhën arabe: “Nga pasuritë e të varfërit për All-llahun Fuqplotë, Halidi, i biri i Ibrahim begut. All-llahu i faltë gjynahet e të dyve. Viti dy e treqind e njëmijë (1302), në muajin Ramazan Mubarek”.

21 - JUSUFI SIDDIK...

Fatmirësisht, në disa prej librave shumë të vjetër, kam arritur të gjej edhe gjurmët e kaligrafisë së dijetarit të madh e të shquar, Jusuf ef. Tabaku, i vlerësuar nga Shejhul-Islami i kohës me gradën

shkencore “Izmiri paji i muxhered”, një gradë më e lartë se “myderriz”, në periudhën osmane, por jo vetëm atë.

Në një prej librave të bibliotekës së tij, me dorën e tij është shënuar: “E ka zotëruar me anë të blerjes, Jusufi Siddik, Myderrizi dhe Myftiu i qytetit Shkodër. E faltë (Zoti)”. Poshtë këtij shënimi ndodhet edhe vula, në brendësi të së cilësi shënohet (arabisht): “Prej librave të Jusuf Siddikut. 1273”.

22 - I VARFËRI HAFIZ ALI KRAJA...

Mbi kopertinën e brendshme të librit “El-Khilafe”, një libër me studime politike, sociale e reformatore të autorit Muhammed Reshid Rida, gjendet edhe një shënim në dy gjuhë, arabisht dhe shqip, me dorën e Hafiz Ali Krajës. Në të, shumë thjeshtë, në gjuhën arabe shënohet: “Posedues i këtij libri është i varfëri, Hafiz Ali Kraja” dhe shënimi në shqip: “H. Ali Kraja”.

23 - NJË LIBËR “VAKËF”...

Ndryshe nga shumë hoxhallarë të vjetër të Shkodrës, Hafiz Muhamed Kastrati, ka pasur një mënyrë personale të shënimit në disa prej librave të bibliotekës së tij. Është shumë interesante dhe ndoshta unike se si ai, i ka bërë vakëf disa prej librave të bibliotekës së tij.

Në shënimin në fjalë, me një kaligrafi të hapur, në gjuhën arabe, shënohet: “Vakëf për hatër të All-llahut të Madhëruar. Nuk shitet as nuk blehet. Hafiz Muhamed Kastrati”.

24 - ROBI, HAFIZ ABAZ...

Prej shënimeve të Hafiz Abaz Golemit, drejtori i parë i shkollës së Parrucës, për 12 vjet me radhë, në një prej librave të bibliotekës së tij, në gjuhën arabe është edhe shënimi i mëposhtëm: “Prej librave të të varfërit, të përlururit, Haxhi Hafiz Abaz, i biri i Haxhi Aliut. I faltë të dy, Falësi, Krijues. Amin!”.

Shumë interesante është edhe përmbajtja e vulës së Hirësisë së Tij, ku shkruhet: “Më i dobëti i njerëzve, robi, Hafiz Abaz. 1307”.

25 - ZOTËRUES ME ANË TË SHKRIMIT...

Prej veçorive, me të cilat është shquar Jusuf ef. Tabaku, është se në posedim të tij ndodheshin libra të shumtë, të cilët i ka kopjuar me dorën e tij nga origjinalet, pas një fatkeqësie që shkatërroi librotekën e familjes së tij.

Në arkivin tim personal, gjenden disa nga këto libra-dorëshkrime. Në njërin

prej tyre, Hirësia e Tij shënon: “Posedues me anë të shkrimit është Jusufi Siddik, Myderrizi dhe Myftiu i qytetit Shkodër. E faltë (Zoti)”.

Ky shënim shoqërohet edhe me vulën e tij personale, për të cilën u fol edhe më lart.

Në njërin prej këtyre librave, të kopjuar me shkrimin e dorës së Hirësisë së Tij, shkruhet: “E shkroi Jusufi Siddik, Myderrizi dhe Myftiu i Shkodrës. All-llahu e faltë atë dhe prindët e tij. 26 Shevval 1286, nata e shtunë, pas akshamit”.

26 - ZOTËRUES ME ANË TË BLERJES...

Në një prej librave të librotekës së tij personale, Jusuf ef. Tabaku, bën një shënim të ngjashëm me të lartpërmendurin, (nr. 25), përveç një dallimi të vogël, që është edhe mënyra e posedimit të librit në fjalë. Shkruan: “Posedues me anë të blerjes, Jusufi Siddik, Myderrizi dhe Myftiu i qytetit Shkodër. E faltë (Zoti)”.

Dallimi është i dukshëm. Nëse në rastin e parë, libri hyn në posedim të tij me anë të shkrimit, pra kopjimit, këtë herë ai posedohet me anë të blerjes.

Njëkohësisht, është shumë e qartë vula e tij personale, ku lexohet shumë qartë edhe data: 1273 h.

27 - ROB I UDHËZUESIT...

Një shënim me vlerë, që kam gjetur mbi kopertinën e një prej librave të teologjisë islame në gjuhën osmane, është edhe ai me dorën e H. Muhamed Bekteshit.

Shënimi është shumë i thjeshtë. Por, e veçantë e tij është njëri prej “esmaul-husnave” (emrave të madhnueshëm hyjnor) të përdorur nga hoxha në fjalë, duke i atribuar vetes robërinë ndaj Tij (xh.sh).

Teksti i plotë i këtij shënimi është: “Prej librave të më të varfërit të krijesave të Udhëzuesit (El-Hadi), Muhammed Teufiku, i biri i Bekër (Beqir) Bektashit”, me “a”.

28 - DËSHMI IXHAZETI...

Ndër gjurmët më të rëndësishme e me vlerë të hoxhallarëve tanë të shkuar, është padyshim edhe dëshmia e ixhazetit, që kanë dhënë për kërkuesit e diturive para duarve tyre.

Njëri ndër këto raste, që kam arritur të zbuloj është edhe dëshmia që Hafiz Jusuf Këlmendi jep për Hafiz Sulejman Gavoçin.

Në fund të ixhazetit, hafzi, nëpërmjet një kaligrafie artistike të mrekullueshme

arabe, dëshmon si më poshtë: “Ky është ixhazeti im për Haxhi Hafiz Sulejman efendiun, sikurse më dhanë ixhazet zotëritë e mi. Unë jam i varfëri, Haxhi Hafiz Jusuf Abdul Këlmendi. All-llahu i faltë të dy!”.

29 - LUTJE PËR FALJE...

Prej gjurmëve të shkruara mbi faqet e librave, që ka lënë Hafiz Myrteza Vuci, është edhe një lutje e shkurtër me një kaligrafi shumë tërheqëse.

Në gjuhën arabe, në fund të kopertinës së brendshme të një libri, pasi ka shënuar emrin e tij, lutet: “E faltë All-llahu atë, prindërit e tij, prindërit tanë, mësuesin tim dhe besimtarët, ditën kur do të bëhet kijameti...”.

30 - MUS’HAFI I VJETËR I HAFIZ MAHMUDIT...

Para ca kohësh, një prej besimtarëve frekuentues të xhamisë së Parrucës, më vuri në dispozicion të hulumtimeve Mus’hafin e vjetër të një prej gjyshërve të tij.

Pasi e shfletova, vura re edhe disa shënime orientuese shumë të dobishme për lexuesin. Ndërkohë, në fund të Librit të Madhnueshëm, në një faqe të shkëputur nga teksti i shenjtë, poseduesi kishte shënuar: “Poseduesi i këtij Mus’hafi është Hafiz Mahmudi, i biri i Tahir begut. Viti 1287 h., 20 xhumadal-evvel”.

Pak më poshtë ndodhet edhe vula personale e poseduesit, ku në arabisht, shënohet vetëm emri i tij: “Mahmud”.

31 - “O ZOT, LEHTËSOJI PUNËT E IBRAHIM HAKIUT”...

Ndër shënimet e lëna nga Hafiz Ibrahim Repishti, është edhe nënshkrimi i posedimit të një libri tefsiri në gjuhën arabe, si pjesë e librotekës së tij.

Me një kaligrafi shumë të pastër e tërheqëse në formë, ai shënon: “Posedues i këtij libri është Ibrahim Hakiu, i biri i Haxhi Hafiz Jusuf efendiut, i biri i Haxhi Ibrahim Repishtit. All-llahu e faltë atë, prindët e tij dhe mbarë besimtarët. Amin për hatrin e zotërisë së të dërguarve (sejjidul-murseline)”.

Shënimi vulolet me vulën personale, në brendësi të së cilës lexohet qartë ky tekst: “O Zot, lehtësoji punët e Ibrahim Hakiut. 1328”.

32 - SH. ALJA...

Shënimin: “Sh. Alja”, që mendoj se duhet të jetë i Sheh Ali Krujës, Prijës i Tarikatit Rifai në Shkodër, që njëjhej

në masë si: Sheh Alja, e kam gjetur mbi faqen e brendshme të një broshure të plotë në gjuhën arabe, me dëmtime anësore, mbi ngjarjen e Israsë dhe Miraxhit.

Broshura në 28 faqe të mëdha, titullohet: “Hashijetul-Imam El-Arif bil-Lah Ebil-Berekat Sejjidi Ahmed Ed-Derdir ala kissatil-Israi vel-Mi’raxh”.

33 - “MEULUDI SALATI SHERIF BUDUR”...

Në një dorëshkrim osmanisht, ku janë regjistruar vargje kushtuar Lindjes ë Begatë të Resulull-llahut (a.s), është regjistruar edhe ky salavat, nën këtë titull: “Meuludi Salati Sherif Budur”, si vijon: “All-llahumme sal-li efdale salatin ala es’adi makhlukatike sejjidina ve nebijjina Muhammed. Ve ala alihi ve sahbihi ve sel-lim. Adede ma’lumatike me midade kelimatike, kul-lema dhekerekedh-dhakirune ve gafele an dhikrikel-gaflune”

34 - “E ZOTËROI NËPËRMJET DHURIMIT...”

Shënimin me dorën e të nderuarit Jusuf ef. Tabaku, në gjuhën arabe, e kam gjetur edhe në faqen e parë të një pjese të mbetur nga një libër sintakse arabe, ku shënohet: “E zotëroi nëpërmjet dhurimit, Jusufi Siddik, Myderriz dhe Myfti i Shkodrës, Zoti e faltë!” Dallohen edhe shenjat e vulës së tij.

35 - HAFIZ SABRI KOÇI...

Shënimin: “Prej librave të Hafiz Mahmudit, të birit të Tahir begut, të birit të Ibrahim begut. All-llahu i faltë ata dhe krejt besimtarët, ditën e gjykimit, për hatër të zotërisë së të parëve dhe të mbramëve. Amin. Viti (1)304 h.”, Shoqëruar me vulën, ku shënohet në arabisht, si vetë shënimi: “Mahmud Hamdi, 1300 h.”

Me një kaligrafi ndryshe nga e lartcituaara, shënohet, po në arabisht: “Ky libër kaloi në dorën e të varfërit, të poshtuarit, nevojtarit për mëshirën e Zotit të tij të Pasur, Sabri, i biri i Idriz Koçit, All-llahu i faltë ata të dy, prindërit tanë dhe besimtarët, ditën e llogarisë. Amin!”

36 - HAFIZ SADIK HAMZA ZAGANJORI...

Në sektorin e trashëgimisë islame të Shkodrës, në librotekën time, ndodhet e plotë edhe vepra me titull: “Hashijetul-Kharbuti ala Tuhfetil-avamil”, në sintaksën e gjuhës arabe. Librin në fjalë, së bashku me një numër të vogël

të librave të ruajtur me shumë frikë dhe amanet, nga libroteka e H. Ali Shoshit, pati mirësinë të ma dhuronte para disa vitesh, nipë i tij, z. Taip Shoshi.

Në faqen e fundit të këtij libri me vlerë, me laps, shënohet në shqip: “H. Sadik Zaganjori”, si dhe në arabisht: “Hafiz Sadiku, i biri i Hamza Zaganjorit”.

37 - SHËNIM ME VLERË NGA H. ALI KRAJA...

Mbi faqet e brendshme të veprës së Sa’d Et-Teftazanit, “Mukhtasarul-meani”, në elokuencë dhe letërsi arabe, shënohet edhe emri i poseduesit të tij të dikurshëm, H. Ali Kraja: “Prej librave të varfërit për mirësitë e Zotit të tij të Plotfuqoshëm, Hafiz Aliu, i biri i Myftarit, I faltë Falësi”.

Me shkrimin e Hafizit të dashur, ndër të tjera janë edhe këto këshilla në gjuhën arabe: “Nxënësi, kur ulet para duarve të Mësuesit, duhet të përfytyrojë mexhlisin e Resulull-llahut (a.s) dhe sahabëve të tij, All-llahu qoftë i kënaqur prej tyre, si dhe ta respektojë Mësuesin e tij. Njëkohësisht, nuk duhet t’ia kthejë fjalën në mënyrë të ftohtë, por të kontrollojë mirë mënyrën e pyetjes dhe të lërë pas dore leximet para mexhlisit të Mësuesit, t’i përkushtohet atij me dëgjimin e tij dhe me prezencën e mendjes, sepse, ndoshta mund të ketë lexuar a kuptuar çfarë mund të mos jetë qëllimi i burimit a shpjeguesit...”

Përkthimin e plotë, inshallah, do ta botoj në një format tjetër.

Libri i lartcituar, ka 253 faqe, sikurse është pasuruar edhe me shënime të shumta me dorën e Hoxhës së ditur, H. Ali Kraja, rahmet pastë.

38 - “MOS U NXITO TË ETIKETOSH GABIM NË FJALË...”

Në faqen e brendshme të kopertinës së parë të njërit prej librave të sintaksës arabe, “Tuhfetul-avamil”, që mban nënshkrimin: “U bë pjesë e pasurisë së të përlurit e të varfrit, Hafiz Ibrahim, i biri i Haxhi Ahmed (...). Viti 1275 h.”, me shkrimin e dorës së Hafiz Ibrahimit, kam gjetur edhe këto rreshta në gjuhën arabe, që ia atribuon autorit të tyre:

“Mos u nxito të etiketosh gabim në fjalë, Paragjykimi, kurrë s’është i drejtë! Sa paragjykes të fjalëve të drejta, Vuajnë nga kuptimet e liga!”

(Këto rreshta është mirë të lexohen, sidomos nga dikush, që e lëshon fjalën, i ngutur emocionalisht, duke paragjykuar qëndrime, dëshmi e fjalë të dikujt, për të

cilat gjithsesi nuk është i obliguar të japë llogari në këtë botë, as do të gjykohet për ta në jetën e përtejme!)

39 - TEFSIRI I SURES “JASIN”, NGA HAMAMI ZADE

Tefsiri i plotë i sures “Jasin”, nga mexhlisi i dijetarit të njohur, si: Hamami Zade dhe botuar në shtypshkronjën e Haxhi Muharrem Efendi boshnjakut, viti 1288 h., ndodhej në posedim të Hoxhës së ndritur, Hafiz Sheuqet Boriçi, rahmet pastë.

Botimi në fjalë, në formatin e një broshure me 49 faqe, është i mbushur me shënime anësore nga hoxha i nderuar shkodran.

Me shkrimin e dorës së tij, ky botim mban edhe shënimin vijues: “Prej librave të varfërit dhe të përlurit, Hafiz Mustafa Sheuqet, i biri i Musa Qazimit, i faltë Falësi Gjykes! Amin!”

40 - H. IBRAHIM REPISHTI, “HANEFIU, TIXHANI”...

Në një shënim anësor me dorën e Hafiz Ibrahim Repishtit, rahmet pastë, kam gjetur edhe këtë dëshmi, unike në llojin e vet: “E shkroi, i varfëri për All-llahun e Pasur, Ibrahim Hakiu, me medhheb hanefi, me tarikat tixhani”.

41 - H. ISUF KARAKAÇI, “IMAMI I RUSIT VOGËL”...

Tridhjetë e dy faqet e para të veprës së Sa’d Et-Teftazanit, me titull: “Mukhtasarul-meani”, në elokuencë arabe, e kam gjetur me një vulë në formë vezake, me ngjyrë blu, ku shënohet: “H. I. Karakaçi”, në mes, “Imami i Rusit vogël”, lart, “Shkodër”, poshtë.

Teksti i vulës është shkruar në gjuhën shqipe.

Gjurmët e H. Isuf Karakaçit gjenden edhe në revistën “Zani i Naltë”, ku zotëria e tij, së bashku me Myftiun e Shkodrës, Tahir ef. Myftija, zhvillojnë debate publike me Sali Vuçiternin, në lidhje me disa çështje që lidhen me sektorin e financave në Komunitetin Mysliman të asaj kohe.

Thuhet, se ai ishte ideatori që rrugës së Çakajve-Karakaçi, t’i vihej emri “Bashkimi”, sepse në këtë zonë kishte shumë shtëpi muslimane, por edhe të besimeve të tjera. Edhe sot e kësaj dite, një nga rrugicat e lagjes Rus mban këtë emër të propozuar prej H. Isuf Karakaçit, rahmet pastë!

42 - “E POSEDOI, I VARFËRI HAFIZ SULEJMAN TRASHANI”...

Tesktin e reduktuar të veprës “Multekal-ebhur”, në fikhun hanefi, si botim i plotë me 193 faqe, botim i vitit 1315 h., e kam gjetur edhe me shënimin anësor: “E posedoi, i varfëri Hafiz Sulejman Trashani”.

Vepra përmban edhe shënimin e botuesit: “Ky është një tekst i reduktuar në shkencën e fikhut (jurisprudencës). Titullohet: “Multekal-ebhur”, i fakihut, dijetarit poliedrik, të përkushtuarit të nderuar... Ibrahim ibn Muhammed ibn Ibrahim El-Halebi, pastë mëshirën e Zotit të tij... Ai ishte imam dhe hatib në xhaminë e Sulltan Muhamed Hanit në qytetin e Kostandinijes... Ai ndërroi jetë në vitin 956 h., pasi kishte kalur 90 vite nga jeta e tij...”

43 - KAMUS TURKI...

“Fjalor Turqisht”, është vepra e madhe në 1575 faqe e Sami Frashërit, që e kam gjetur me shënimin anësor: “I zoti i këtij libër është Ibrahim Hakiu, i biri i Haxhi Hafiz Jusuf efendi Repishtit. All-llahu ia faltë gjynahet të dyve dhe gjynahet e besimtarëve! Amin!”

Autori i këtij fjalori të madh, “Sh. Sami”, Shemsudin Samiu i famshëm, në fund të veprës ka lënë edhe këtë shënim: “Falënderimi i takon All-llahut për plotësimin e veprës, më 7 nëntor të vitit 1317, në mëngjes, në orën 2 e 15 minuta në Erenköy. Ndërkohë, fillimi i kësaj pune ishte me 15 tetor 1315. Samiu”.

44 - HAFIZ JUSUF KËLMENDI...

“Prej librave të Haxhi Hafiz Jusufit, të birit të Abdyl (Abdullah) Këlmendit. Viti 1330”, është nënshkrimi mbi një vepër të dijetarit të shquar Meulana Shejkh Hasen El-Adevi El-Hamzavi, në medhhebin maliki.

Hafiz Jusuf Këlmendi, rahmet pastë, ka qenë një dijetar elitar i qytetit të Shkodrës, prej duarve të cilit kanë dalë një numër i konsiderueshëm hoxhallarësh të nderuar, që kanë lënë gjurmët e tyre në shërbim të Thirrjes Islame në vendin tonë dhe jashtë tij.

Vargu i hoxhallarëve të ixhazetit të tij, mbërrin në mënyrë të pashkëputur, nga Hoxha i tij, H. Halid Bushati, deri te Resulull-llahu (a.s). Teksa tregon për marrëdhënien me Hoxhën e tij, në ixhazetin që i ka dhënë nxënësit të tij, H. Sulejman Gavoci, ndër të tjera, shkruan: “Në dersin e tij qëndrova për një kohë të gjatë dhe u ruajta të mos hy aty ku nuk më takon në këtë çështje, sa që në praninë e tij qëndroja si të isha udhëtar, ndonëse isha prezent!”

Rahmet paçin, çfarë edukate dhe etike komunikimi kanë pasur me Mësuesit dhe Edukatorët e fesë!

45 - H. HALID MERTOSHI...

Emrin e Hoxhës së dashur, H. Halid Mertoshi, e kam gjetur mbi mbetjet e disa veprave në gjuhën arabe, ndonëse, i nderuari i përket kohës së fundit të talebeve të H. Muhamed Bektshit, rahmet pastë.

“Halid Mertoshi”, e kam gjetur mbi faqen e parë të lëndës së vëllimit të tretë të veprës: “Sahihul-Bukhari”, në gjuhën arabe.

Emrin e tij e kam gjetur të shënuar edhe në mbetjet e veprës: “Hashijetut-Tahtavi ala Merakil-felah Sherh Nurul-idah”, në medhhebin e Imam Ebu Hanife Numanit, radijall-llahu anhu. “I zoti i këtij libri është Halid Mertoshi”, shënohet mbi faqen e brendshme të kësaj vepre.

Zotërinë e tij, kam pasur fatin ta njoh nga afër dhe ta shoqëroj me një emocion dhe respekt të madh, në vitet e para të rimëkëmbjes së fesë në vendin tonë, teksa ai, ishte i vetmi Hoxhë me çallmë e xhybe dhe mjekrën thujse të bardhë, që lëvizte në këmbë nëpër rrugët e Shkodrës. Bëhet fjalë për ditët e para të vitit 1991.

46 - HAFIZ YMER ED’HEM BAKALLI...

Sonte përjetova një emocion të papërshkrueshëm, teksa zbulova një dorëshkrim origjinal, me autor dijetarin e shquar shkodran, Hafiz Ymer Bakalli, rahmet pastë.

Materiali në fjalë, (për të cilin nuk do të flas me hollësi tani), ka një vlerë të madhe në trajtimin e pozitës së sahabëve në Islam dhe distancimin nga etiketimet fanatike dhe injorante në hak të tyre, është shkruar me dorën e Hoxhës së ditur në fletë të bardha, me stilograf me ngjyrë të zezë, është i qepur në mes dhe ka dy kopertina të trasha me zbukurime orientale.

Dorëshkrimi është ndarë në dy tema, të cilat autori i trajton paralelisht, të ndara nga njëra-tjetra, brenda secilës faqe. Pra, kemi të bëjmë me dy trajtesa rreth një teme, në një dorëshkrim të vetëm.

E krahasova shkrimin e tij me disa dorëshkrime të tjera të zotërisë së tij dhe dola në përfundimin e autenticitetit të tij, pavarësisht shënimeve përforcuese, si vijon:

– Në faqen e parë të dorëshkrimit, shënon: “E grumbulluesit të tij, të varfrit,



të përlurit, nevojtar për mirësitë e Zotit të tij të Plotfuqishëm, Omeri (Ymer), i biri i Ed’hem (Et’hem) shkodranit, Zoti e faltë”.

– Në përfundim të dorëshkrimit, autori shënon: “All-llahumme na bëj të kapemi pas sheriatit muhammedi dhe prej atyre që pasojnë traditat e të Dërguarit, që të fitojmë nëpërmjet tyre gradët e larta dhe të meritojmë nëpërmjet tyre ndërmjetësimin e tij (shefatin), All-llahu e begatoftë atë, familjen e tij të respektuar dhe shokët e tij të nderuar, të cilët e pasuan atë në çdo gjendje e situatë.

U përfundua shkrimi i tij (i këtij libri –M.S.-) në muajin, në të cilin u lind Zotëria i njerëzisë, Muhammedi (a.s), nga muajt e vitit 1341 nga hixhreti i atij që është rrethuar me nder e krenari.

Ndërsa unë jam i varfëri, i huaji (el-garib), duarboshi (adimel-bidaati), i pamunduri Omeri, i biri i Ed’hem shkodranit, i faltë të dy Mbreti i Plotpushtetshëm...”

Pra, bëhet fjalë për një dorëshkrim 97 vjeçar nga njëri prej hoxhallarëve të shquar të Shkodrës, elhamdulillah!

47 - “SURE-I JASIN” DHE NJOHURITË FILLESTARE TË FESË ISLAME

Poashtu sonde, kam zbuluar një fletore ku janë shkruar me shkrim dore të kuptueshëm, në gjuhën shqipe, sureja “Jasin”, dhjetë suret e fundit të Kur’anit, sureja “El-Fatiha”, si dhe kushtet e besimit, ato të Islamit, rregullat e faljes së namazit, mënyra e faljes së namazit, duatë e namazit, llojet e namazeve, me detaje, teksti i ezanit etj.

Dorëshkrimi në fjalë, që meriton të botohet dhe të shërbejë për mësimin e fëmijëve që ndjekin kurset fillestare të fesë islame në xhamitë e vendit tonë, por jo vetëm, mban këtë shënim në kopertinë e tij: “Hafiz Qazim Ismail – Sure-i Jasini Sherif – Shkodër – Shpija Botuese “Ora”, 1935”.

48 - HAFIZ ADEM KAZAZI...

Emrin e të nderuarit, Hafiz Adem Kazazi, e kam dëgjuar për herë të parë nga gjyshi im rahmetli. Ai përherë e kujtonte me respekt Hoxhën, për të cilin thoshte se nëna e tij, Emine, e kishte pasur dajë.

Një pjesë të trashëgimisë së mbetur nga librat e tij, kam fatin t’i kem në rrjetin e librotekës sime, pas mirësisë së bijës së Hoxhës, e cila, së bashku me familjarët e saj të nderuar vendosën të m’i dhurojnë. All-llahu ia shpërbëftë!

Me shënimet e dorës së tij kam në posedim edhe librin e titulluar: “Hashijetu dibaxheti ed-Dur en-Naxhi”, në gjuhën arabe. Librin në fjalë, është i mbushur me shënime anësore me dorën e Hafiz Adem Kazazit; shënime që karakterizohen nga një arabishte e pastër dhe e pasur.

Njëkohësisht, në faqen e parë, me shkrimin e tij shënon: “Posedues i këtij libri me vlerë është Hafiz Adem Kazazi”.

49 - DORËSHKRIM I AHMED IBN MUHAMMED IBN SAID EL-GAZNEVI...

Një dorëshkrim me vlerë mbi vlerën e dijes dhe dijetarëve, nga autori Ahmed ibn Muhammed ibn Said El-Gaznevi, gjendet me nënshkrimin e Hafiz Adem Kazazit, kun ë faqen e parë të këtij dorëshkrimi me vlerë, shënon: “I zoti (i këtij dorëshkrim), Hafiz Adem Kazazi.

Ndër dobitë e tij, mund të përmend: [Ka thënë fakihu Ebul-Lejth (r.a): “Nga dijetari kërkohen dhjetë gjëra: Frika e All-llahut, këshilla, dhembshuria, durimi...” Etj.

Në fund të këtij dorëshkrimi, shënohet edhe ky detaj me vlerë: “U përfundua pas mesdite. Viti 1285 h.”

Pra, fatmirësisht, kemi të bëjmë me një dorëshkrim të shkruar para 153 vitesh dhe të ruajtur me shumë përkushtim, Elhamdulillah!

50 - “NGA AJO, ME ÇFARË E BEGATOI ALL-LLAHU, ROBIN E TIJ TË VARFËR...”

Tetë faqet e para të librit me titull: “El-Hasidetun-Nebevijje sherhul-Kasidetil-Medenijje”, të autorit Haxhi Muhammed Feuzi, “i njohur si Myftiu i shkuar i Edrenesë”, në gjuhën arabe, i kam gjetur me këtë shënim interesant: “Nga ajo, me çfarë e begatoi All-llahu, robin e Tij të varfër Halid Shukri, i biri i Adem efendiut, i biri i Salih efendiut, Zoti i faltë. Viti 1320 h.” Ky shënim shoqërohet edhe me vulën e rrumbullakët, ku shënohet: “Halid Shukri. 1320”.



Sheikh Muhamed El-Gazali

Po t'i hedhim një sy adhurimeve hyjnore në Islam do të vëmë re se realizimi i tyre brenda 24 orëve nuk merr më tepër se një gjysmë ore, ndërsa mësimi i tyre përmbledhet në një fletë apo në dy të tilla. Koha tjetër që mbetet është e madhe për të kuptuar jetën, për zbulimin e energjive të saj dhe për t'i vënë ato në shërbim të fesë.

Çdo sakrificë dhe përpjekje në këtë drejtim quhet juridikisht punë e mirë, sakrificë e pëlqyer e pranueshme dhe forcim besimi, i cili e bën të gatshëm njeriun të fitojë kënaqësinë e Zotit (xh.sh).

“E kush bën ndonjë vepër të mirë dhe është besimtar, munda i tij nuk i mohohet, sepse Ne i shënojmë ato”¹.

Është e pamundur ngritja e një shoqërie, n.q.s pjesëtarët e saj janë injorantë ndaj kësaj bote, të pafuqishëm në këtë jetë. Punët e mira kërkohet që t'i bëjë sëpata e druvarit, gjilpëra e rrobaqepësit, lapsi i shkrimtarit, ekspertiza e doktorit, provëza e farmacistit. I bën ato polumbari në det, piloti në qiell, shkencëtari në laborator, ekonomisti në planin e tij. Duhet t'i bëjë ato çdo mysliman që është anëtar i mesazhit hyjnor, kur ai merr përsipër çdo gjë duke i përdorë sendet si mjete për të ndihmuar fenë e Zotit dhe për të mbajtur lart fjalën e Tij!

1. Sureja Enbija, ajeti 94

E VËRTETA E ADHURIMIT

“E kush bën ndonjë vepër të mirë dhe është besimtar, munda i tij nuk i mohohet, sepse Ne i shënojmë ato” - (El-Enbija: 94)

Ishte dështim, për të cilin paguam një çmim shumë të lartë, kur humbëm në fushat e jetës. Menduam se shpërblimi i Allahut është në disa fjalë që thuhet, apo në formalitete sipërfaqësore që kryhen.

Imagjinoni një njeri me pozitë të lartë qeverisëse, ku u thotë vartësve të tij: Përpara jush është institucioni shtetëror, udhëhiqini atë për të vërtetuar ekzistencën tuaj dhe për të realizuar qëllimet. Po qe se ata do ta udhëheqin keq këtë institucion, duke u mbledhur sa për të folur, por jo për të vepruar dhe bashkëpunuar në dobi të punës, n.q.s eprori i tyre do t'i largonte nga institucioni nuk do të bënte padrejtësi. Madje, edhe sikur të urdhëronte rojet për t'i rrahur nuk do t'u kishte bërë zullum. Ata janë me të vërtetë shkatërrues dhe jo të sinqertë!

Dikur në një kohë një grup besimtarësh e panë të arsyeshme që adhurimin e tyre ta kufizonin vetëm në namaz, përmendje të Zotit, duke i përsëritur e stërpërsëritur, duke menduar se popujt përparojnë me murmurima, papunësi, dembelizëm etj. Atëherë kush e ndihmon fenë e Zotit dhe të Dërguarin e Tij? Kur këta të jenë injorantë në nxjerrjen e hekurit, shkrirjen dhe përpunimin e tij? Kur Allahu thotë në librin e Tij: “Dhe Ne e zbritëm hekurin ku në të ka forcë të madhe, dobi për njerëzit dhe që ta dijë Allahu se kush e ndihmon Atë (fenë e Tij) dhe të dërguarit e Tij në mënyrë të fshehtë”².

Ekzistojnë rreth 70 procese civile dhe ushtarake që kanë lidhje me naftën, nxjerrjen dhe përpunimin e

nënprodukteve të saj, për të cilat nuk dimë asgjë. Atëherë a i shërbejmë akides së tevhidit dhe gjithçka që ka lidhje me të, me gjithë këtë paaftësi dhe nënçmim?

“Sikur t'u thuhej gjërave që ndodhen në vendet islame: Kthehuni andej nga keni ardhur, do kisha pasur frikë se mos njerëzit do ecnin lakuriq e këmbëzbathur, nuk do gjenin, prej punimeve të duarve të tyre, çfarë të mbathnin ose çfarë të vishnin, në çfarë të hipnin dhe me çfarë të ndriçonin shtëpitë e tyre. Madje do isha frikësuar se mos pllakoste zija e bukës, sepse vendet e tyre nuk sigurojnë për vete as atë që u nevojitet për bukën e gojës”.

Allahu nuk e pranon këtë fetarizëm, të cilin po e turpëron ky parazitizëm i paparë. Nuk e kuptoj se si pretendojmë besimin dhe xhihadin, kur ne po vuajmë nga ky parazit, i cili po bën të tjerët, në qoftë se dëshirojnë, të na ushqejnë e të na mjekojnë dhe, të na furnizojnë me armë. Pa dyshim ky është një parazitizëm që i hap rrugë dominimit të huaj.

Kam parë shumë të rinj, të cilët kanë dëshirë t'i shërbejnë fesë, por më frikëson mendjelehtësia e tyre e trashëguar. Ata nuk e konsiderojnë djersën e derdhur në kërkim të naftës, apo ndotjen e rrobave nga veglat e nxjerrjes së saj, nuk e konsiderojnë këtë gjë përpjekje dhe sakrificë. Tek ata sakrificë është vetëm leximi i Kur'anit, përmendja e Zotit dhe përsëritja çka t'u vijë më lehtë, mbasi vazhdojnë të kenë mjaft kohë!

Më ka sjellë rasti të njoh një farmacist, i cili ishte i zënë me kërkimin

“Sikur t'u thuhej gjërave që ndodhen në vendet islame: Kthehuni andej nga keni ardhur, do kisha pasur frikë se mos njerëzit do ecnin lakuriq e këmbëzbathur, nuk do gjenin, prej punimeve të duarve të tyre, çfarë të mbathnin ose çfarë të vishnin, në çfarë të hipnin dhe me çfarë të ndriçonin shtëpitë e tyre. Madje do isha frikësuar se mos pllakoste zija e bukës, sepse vendet e tyre nuk sigurojnë për vete as atë që u nevojitet për bukën e gojës”.

e çështjes, “namazi te hijet ul mesxhid”³, gjatë hytbes së xhumasë dhe shumë i interesuar për preferencat e secilit medhheb.

I thashë: Përse nuk ndihmon Islamin në specialitetin tënd dhe t'ia lësh këtë temë njerëzve përkatës që janë të zotë rreth kësaj çështjeje?

Me të vërtetë Islami, në fushën e farmaceutikës është i mposhtur! Sikur armiqtë e Islamit të mendonin për të helmuar ymetin tonë në këtë fushë, pa vështirësi do ta bënë dhe ju do të ishit të paaftë për ta mbrojtur!

A s'do kishte qenë më mirë për ty dhe për vëllezërit tuaj të prodhoni diçka për fenë tuaj në fushën, e cila është fare bosh, në vend që të hyni në preferencat mes shafijve dhe malikive?

Një student i fakultetit të kimisë më pyeti për një çështje jo të qartë në shkencën e teologjisë! Thashë me vete: Çmimi Nobel këtë vit iu dha një grupi shkencëtarësh në fushën e kimisë, në mes tyre nuk ndodhej asnjë arab, ndërsa nevoja e myslimanëve për t'u thelluar në shkencën e kimisë është më se e domosdoshme.

Në disa libra të mi kam sjell shembuj se si arritën rusët të shfarosnin një fshat të tërë, duke përdorur mbi të një sulm kimik. Viktimat u harruan, pa u dëgjuar nga myslimanët asnjë lajm dhe ata nuk dinin gjë se çka kishte ndodhur apo çfarë po ndodhte.

Studentit që pyet i thashë: Për ty, më mirë është që të largohesh nga kjo temë e t'i përvishesh me forcë asaj për të cilën je specializuar. Ne jemi shumë të varfër për talente në fushën ku jeni duke studiuar dhe shumë të pasur në fushën e filozofisë e të llafollogjisë.

Duke qeshur i kërkova të më ndiqte: dikur kimia në kohëra të vjetra ka qenë e interesuar për shndërrimin e mineraleve jo të çmueshme në ar. Poetët kanë folur për kiminë e fateve, e cila ngre të

3. Tehijet ul mesxhid: namazi që falet si përsëritje kur hynë në xhami.

përbuzurën në vende të larta!

Më pyeti përsëri dhe ai duke qeshur për këtë kiminë e fateve?

I përmenda dy vargje të Ibn Rumi:

“Me të vërtetë për fatin ekziston kimi - kur ta prekin qenin e shndërronë njeri”

Zoti ngre lart kë të dojë, kur të dojë - dhe si të dojë, të jetë kush të jetë!

S'ka dyshim që fati luan një rol të madh në jetë, por ai është rol dytësor dhe i kufizuar. Ndërsa lartësimi i popujve edhe rënia e tyre ka të bëjë me ligje rigorozë e forca plot seriozitet. Myslimanëve nuk u është bërë padrejtësi kur dështuan në garën e jetës! Ata keqinterpretuan domethënien e fetarizmit dhe me të drejtë pësuan disfatë.

U ktheva dhe i thashë: Thelloju në shkencën e kimisë, kjo është më e vlefshme për Islamin se sa të zhytesh në lexime fetare, specialitet i cili nuk është detyrë e jotja, të mjafton dituria në fe, aq sa të përkushtojë zemrën tënde kur të lexosh Kur'an, pastaj ec pas të Dërguarit tënd të përkryer dhe mëso nga ai se si arriti të ndryshojë botën me emrin e Allahut.

U largova prej studentit i hutuar, pa e kuptuar nëse e binda apo jo!

Ai dhe shumë prej të rinjve mendojnë se devotshmëria ka të bëjë me shpenzimin e pjesës më të madhe të kohës në lexime fetare dhe përkushtimi në një pjesë fare të vogël të kohës për çështjet e kësaj bote dhe shkencat e jetës. Betohem se, Islami s'ka për të pasur dobi nga kjo prirje, n.q.s ndjekësit e tij janë në marrëzitë e hindusëve, ndërsa armiqtë zotërojnë rrugët e universit!

Zotëro kontrollin e botës me dituri e aftësi, që të kesh mundësi të ndihmosh të vërtetën, të cilën e ke përqafuar. Në rast se nuk vepron kështu do ta kalojnë të aftët e të zgjuarit!

(Nga libri: “Probleme në rrugën e jetës islame”, përkthet nga arabishtja: Lavdrim Hamja)

MODESTIA DHE ALTRUIZMI...

Dr. Aid el-Karni



JETA ËSHTË E SHKURTË. E TË GJITHË NE SHKOJM DREJT VDEKJES. DHE ORIGJINA E TË GJITHË NEVE, ËSHTË NGA NJË NËNË DHE BABA. NE NUK MUNDËMI TA FALËNDEROJM ASNJËHERË ALLAHUN PËR MIRËSITË E TIJA QË I KA DERRDHUR MBI NEVE, POR AI ËSHTË QË NA NDERON ME TO NË VAZHDIMËSI. MOS E NGRIT VETEN KURRË, POR GJITHMONË BËJE TË KUNDËRTËN E SAJ – JI MODEST.

PËRULË KOKËN TËNDE PARA ZOTIT TË GJITHËMBARSHËM DHE PLOTË MADHËSHTRI. SEPSE TI JE DHE, JETON MBI DHË, DHE DO TË FUTESH NË DHË.

MOS I MUNDËSO ASKUJT TË TË KARAKTERIZOJË SI TË NËNVLERËSUAR APO TË NËNÇMUAR. JEPU TË TJERËVE SHANSIN QË TË QËZOHEN ME SUKSESET E TYRE. DHUROJU ATYRE NJË INTERESIM, POPULLARITET DHE MODESTI NGA ANA JOTE QË TË JESH TEK ATA MË I DASHUR SE SA BIJTË E TYRE...

ALTRUIZËM

PËRMBAJU ALTRUIZMIT. NDERË ËSHTË TË VETËSAKRIFIKOHESH PËR TË TJERËT. ME TË VËRTET SE USHOIMI YT QË TRETET NË BARKUN E TJETRIT, ËSHTË MË I SHIJSHËM DHE MË I LEZETSHËM SE SA TË JETË DUKE U TRETUR NË BARKUN TËND.

POASHTU EDHE AJO RROBA JOTE E CILA KA MBULUAR TRUPIN E TJETRIT, SHFAQË MË TEPËR BUKURI SE SA TË JETË DUKE MBULUAR TRUPIN TËND. SAKRIFIKOJE PASURINË TËNDE, USHOIMIN TËND, KOHËN TËNDE PËR NJERËZIT. MË PAS TI DO TË JESH MË I LUMTURI I NJERËZVE!

(www.fjalaebukur.net)

“DHE NE E ZBRITËM HEKURIN KU NË TË KA FORCË TË MADHE, DOBI PËR NJERËZIT DHE QË TA DIJË ALLAHU SE KUSH E NDHMON ATË (FENË E TIJ) DHE TË DËRQUARIT E TIJ NË MËNYRË TË FSHEHTË”



KONKURSI I 7-TË VJETOR I KURSEVE FETARE TË MYFTINISË SHKODËR

Paraditën e së shtunës, më 29 prill 2017, në ambientet e xhamisë së Fushë Çelës, nisi konkursi i 7-të vjetor i kurseve fetare të xhamive të Shkodrës.

Aktiviteti, që mbledhi me qindra fëmijë frekuentues të kurseve sistematike të xhamive tona, nisi me leximin e një pjese kur'anire, që u pasua me fjalën e rastit nga përgjegjësi i arsimit në Myftininë e Shkodrës, teologu Arben Halluni.

Një mesazh prindëror plot lutje dhe bekime, dha edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili u lut për mbarësinë e fëmijëve të pranishëm dhe suksesin e tyre në rrugën e brumosjes me edukatën dhe botëkuptimin islam.

"E shihni rrethimin e kësaj xhamie dhe të krejt vakëfeve të shenjta në Shkodër? Fiksojini mirë! Ato janë mudi, gjaku, djersa dhe hallalli i paraardhësve tanë, që na lanë amanet shpirtin e bamirësisë dhe edukimin me frymën e besimit dhe fesë sonë të pastër islame.

Sot, ju jeni dëshmia më e mirë e shpirtit të besimit dhe fesë së pastër që ripërtërihet në zemrat e kësaj shoqërie, që lëngon pa masë!", tha ndër të tjera Myftiu!

Aktiviteti vijoi me konkursin e madh vjetor, si dhe lojrat e ndryshme sportive, që mbushën këtë ditë të dëshmuar me mirësi e paqe.


Aktiviteti i konkursit të madh fetar me një pjesëmarrje mbi 600 nxënës u shoqërua me lojëra sportive dhe zbavitëse në ambientet e jashtme të xhamisë "Ebu Bekër" si dhe me një program të larmishëm si: recitime, këndim ilahi dhe lexim të ajeteve të Kur'anit Famëlartë etj.

Në fund u zhvillua ceremonia e shpalljes së fituesve, ku juria e përbërë nga teologët Lavdrim Hamja, Naim Drijaj dhe Altin Nikshiqi vendosën në bazë të pikëve maksimale për çmimin e parë: Anisa Dani, xhamia Bardhaj, çmimi i dytë: Skendi Kasemi, xhamia e "Dy Vajzave", dhe çmimi i tretë: Hafsa Plangaj, xhamia Kiras.

Gjithashtu u dha edhe çmimi për zërin e bukur në leximin e Kur'anit, që u shpall nxënësi Sulejman Milani, xhamia Milan.

Më pas, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër shpalli 6 çmime (fletë lavdërimi) për nxënësit që kanë spikatur gjatë konkursit fetar dhe gjithashtu të dalluar në procesin mësimor të kursit fetar: Matteo Çeliku, xhamia Golem, Jusra Repaj, xhamia Boks, Kledion Kastrati, xhamia Bahçallëk, Selim Jakupi, xhamia Luarëz, Arben Kallaj, xhamia Mes-Myselim dhe Ersada Hasani, xhamia Alimetaj.





Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

MESAZHI I MIRAXHIT...

i ka paraparë këto kriza dhe ka tërhequr vërejtjen.

Duhet kuptuar që hapësira dhe koha nuk janë në favor tonin për atë që jemi muslimanë. Edhe hapësira edhe koha janë aleatë i atij që i kupton.

Mbledhja e gjithë pejgamberëve dhe pejgamberit tonë Muhammedit (a.s) në një vend është tregues i unitetit njerëzor bajraktar i të cilëve është pejgamberi i fundit, Muhammedi (a.s).

Miraxhi gjithashtu bëri ndarjen dhe seleksionimin në mes besimtarëve të sinqertë dhe hipokritëve.

Miraxhi tregoi mëshirën e Allahut të madhërishtëm ndaj njerëzve, por edhe tërë fisnikërinë e Pejgamberit (a.s) Ky pejgamber (a.s) i dha përparësi ummetit mbi veten. Kur i Lartësuar i pyeti çfarë dëshiron nga Ai, Pejgamberi (a.s) asgjë nuk kërkoi për vete. Nuk kërkoi shpërblim që do ta kënaqte shpirtin e tij. Jo, por përparësi i jep Ummetit. Duke na mësuar njëherit edhe neve që me sakrificë dhe punë për mirëqenien e të gjithëve vërtetohet madhështia morale e njeriut. Ai i tha Allahut të madhërishtëm: “Nuk do të jem i kënaqur përderisa është një njeri nga ummeti im në zjarr.”

NAMAZI ËSHTË MIRAXHI I BESIMTARIT

Një gjë tejet e rëndësishme që duhet potencuar kur flitet për Miraxhin është fakti që Pejgamberi (a.s) nga ky udhëtim madhështor, ummetit i kthehet me urdhrin e faljes së pesë kohëve të namazit. Sa i fuqishëm është ky urdhër dëshmon fakti se ju shpallë Pejgamberit (a.s) kur ishte në vendin më të lartë, ndërsa urdhrat tjerë sikurse agjërimi, zekati, haxhi, etj. zbritën nëpërmes Xhibrilit (a.s) në tokë.

Namazi, pra është obligimi i urdhëruar në sferat më të larta, për këtë duhet të ruhet shumë.

Namazi është dhuratë e artë që Pejgamberi (a.s) na solli nga vendi më fisnik.

Kjo dhuratë na mundëson takimin pesë herë në ditë me Zotin e botëve. A ka diç më të bukur se kjo? Hyrja në namaz do të thotë hyrje në audiencën Hyjnore. Në momentin kur robi e thotë tekbinin fillestar “Allahu ekber” i Lartësuar kthehet kah ai dhe e shikon. Në këtë mënyrë secili, individualisht mund të ketë miraxhin personal. Duke u falur prej njërit në namazin tjetër, musal-liu për çdo ditë në kohë të caktuar shkëmben përshëndetjet me Zotin në të njëjtën mënyrë siç bëri edhe Pejgamberi (a.s) në Miraxh.

Vepra më e vlefshme, thotë Pejgamberi (a.s): “Namazi në kohën e tij”. Gjithashtu në hadithet e saktë transmetohet që Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Namazi është çelësi i Xhennetit!”, “Namazi është drita e besimtarit!”, “Namazi është ilaç i besimtarit!”

Namazi është qëllimi i ekzistencës. Për këtë edhe njeriu është krijuar: “Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, pos që të më adhurojnë.” (Edh - Dharijatë, 56)

Është interesant që edhe fjalët e fundit që Pejgamberi (a.s) ia drejtoi ummetit ishin: “Namazi o ummet, namazi. Dhe frikësohuni Allahut në çështjen e atyre që i keni në pronësinë tuaj.”

O Zoti ynë, premtimi Yt që ia dha Pejgamberit (a.s) në Miraxh është i fuqishëm. Na bëj pasues të sinqertë të ummetit tij dhe na mundëso ndërmjetësimin e tij në ditën e Gjykimit!

(www.islamgjakova.net)

ISRAJA DHE MIRAXHI SIPAS HADITHIT TË SAKTË

“TAKOVA IBRAHIMIN NATËN E ISRASË DHE MË THA: O MUHAMMED, BËJI SELAM YMETIT TËND PREJ MEJE DHE LAJMËROJI SE XHENNETI E KA TOKËN E MIRË, UJIN E ËMBËL, FUSHË E SHTRIRË, QË MBILLET ME SUBHANALL-LAH, ME ELHAMDU LIL-LAH, ME LA ILAHE IL-LALL-LAH DHE ME ALL-LLAHU EKBER!”

Në një transmetim të Bukhariut, nga Hz. Ebu Dherri (r.a), thuhet kështu: “Kur u hap dera, u ngjitëm në qiellin e botës tonë, ku pashë një burrë të ulur; në të djathtë e në të majtë kishte disa forma shpirttrash. Kur sillte kokën djathtas, qeshte e, kur e sillte majtas, qante. Më tha: Mirë se erdhe, o profet i mirë, o djalë i mirë! E pyeta Xhibrilin: Kush është ky? Tha: Ademi (a.s). Ndërsa këto forma shpirttrash djathtas e majtas tij, janë shpirtat e fëmijëve të tij; në të djathtën e tij, banorët e xhennetit dhe në të majtën e tij, banorët e xhehenemit.

Pastaj u ngjitëm derisa erdhëm në qiellin e dytë. Trokiti. Dikush tha: Kush është? Tha: Xhibrili jam. Pyeti: Kush është me ty? (Xhibrili) Tha: Muhammedi! Pyeti: A është dërguar? (Xhibrili) Tha: Po! Ia ktheu: Mirë se ka ardhur, në vendin më të mirë ka ardhur! Dhe, e hapi derën.

Kur kaluam, pashë Jahjanë dhe Isain, dy djem tezesh. (Xhibrili) Më tha: Këta janë Jahjai dhe Isai, jepu selam. U dhashë selam. Ma kthyen, pastaj thanë: Mirë se vjen, o vëlla i mirë, o profet i mirë!

Pastaj u ngjitëm në qiellin e tretë. Trokiti. Dikush tha: Kush është? Tha: Xhibrili jam. Pyeti: Kush është me ty? (Xhibrili) Tha: Muhammedi! Pyeti: A është dërguar? (Xhibrili) Tha: Po! Ia ktheu: Mirë se ka ardhur, në vendin më të mirë ka ardhur! Dhe, e hapi derën.

Kur kaluam, pashë Jusufin. (Xhibrili) Më tha: Ky është Jusufi, jepi selam. I dhashë selam. Ma ktheu, pastaj tha: Mirë se vjen, o vëlla i mirë, o profet i mirë!

Pastaj u ngjitëm në qiellin e katërt. Trokiti. Dikush tha: Kush është? Tha: Xhibrili jam. Pyeti: Kush është me ty? (Xhibrili) Tha: Muhammedi! Pyeti: A është dërguar? (Xhibrili) Tha: Po! Ia ktheu: Mirë se ka ardhur, në vendin më të mirë ka ardhur! Dhe, e hapi derën.

Kur kaluam, pashë Idrisin. (Xhibrili) Më tha: Ky është Idrisi, jepi selam. I dhashë selam. Ma ktheu, pastaj tha: Mirë se vjen, o vëlla i mirë, o profet i mirë!

Pastaj u ngjitëm në qiellin e pestë. Trokiti. Dikush tha: Kush është? Tha: Xhibrili jam. Pyeti: Kush është me ty? (Xhibrili) Tha: Muhammedi! Pyeti: A është dërguar? (Xhibrili) Tha: Po! Ia ktheu: Mirë se ka ardhur, në vendin më të mirë ka ardhur! Dhe, e hapi derën.

Kur kaluam, pashë Harunin. (Xhibrili) Më tha: Ky është Haruni, jepi selam. I dhashë selam. Ma ktheu, pastaj tha: Mirë se vjen, o vëlla i mirë, o profet i mirë!

Pastaj u ngjitëm në qiellin e gjashtë. Trokiti. Dikush tha: Kush është? Tha: Xhibrili jam. Pyeti: Kush është me ty? (Xhibrili) Tha: Muhammedi! Pyeti: A është dërguar? (Xhibrili) Tha: Po! Ia ktheu: Mirë se ka ardhur, në vendin më të mirë ka ardhur! Dhe, e hapi derën.


Kur kaluam, pashë Musain. (Xhibrili) Më tha: Ky është Musai, jepi selam. I dhashë selam. Ma ktheu, pastaj tha: Mirë se vjen, o vëlla i mirë, o profet i mirë!

Kur mora të largohem, ai nisi të qante. I thanë: Pse po qan? Tha: Po qaj, sepse një djalë i ri është dërguar pas meje, në xhennete do të hynë më shumë nga ymeti i tij sesa nga ymeti im!”

Pastaj u ngjitëm në qiellin e shtatë. Trokiti. Dikush tha: Kush është? Tha: Xhibrili jam. Pyeti: Kush është me ty? (Xhibrili) Tha: Muhammedi! Pyeti: A është dërguar? (Xhibrili) Tha: Po! Ia ktheu: Mirë se ka ardhur, në vendin më të mirë ka ardhur! Dhe, e hapi derën.

Kur kaluam, pashë Ibrahimin. (Xhibrili) Më tha: Ky është Ibrahim, babi yt, jepi selam. I dhashë selam. Ma ktheu, pastaj tha: Mirë se vjen, o djalë i mirë, o profet i mirë!”

Ndërsa në transmetimin e Tirmidhiut, nga Hz. Abdull-llah ibn Mesudi (r.a): “Takova Ibrahimin natën e Israsë dhe më tha: O Muhammed, bëji selam ymetit tënd prej meje dhe lajmëroji se xhenneti e ka tokën e mirë, ujin e ëmbël, fushën e shtrirë, që mbillet me Subhanall-llah, me Elhamdu lil-lah, me La ilahe il-lall-llah dhe me All-llahu ekber!”



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“Sikur ta dinin njerëzit

se, çfarë (shpërblimi)

ka në thirrjen e ezanit

dhe në safin (rreshtin)

e parë (në namaz),

atëherë

nuk do të kishin

gjetur zgjidhje për të,

veçse të hedhin short”.

(Buhariu dhe Muslimi)

Ditën e mërkurë, më 5 prill 2017, në xhaminë e Trushit, u zhvillua një aktivitet i bukur fetar, kushtuar përkujtimin të lindjes, jetës dhe traditave të Hz. Muhamedit (a.s).

Pas leximit të një pjese kur'anore nga H. Shukri Kapllan, fjalën e rastit e mbajti imami i xhamisë, H. Jetmir Braqi. Në fjalën e tij, imami i nderuar theksoi se tubime të tilla, ku përkujtohen vlerat e besimit, bëhet dhikër e përmendet me salavate Hz. Muhamedi (a.s), kanë bekimet e All-llahut të Madhëruar dhe mëshirën e Tij.

Ligjërata e rastit u mbajt nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili hodhi dritë mbi rëndësinë që ka mbajtja e besës së fesë në jetë.

Myftiu tha se, sot, kudo nëpër botë muslimanët paragjykojnë për diçka që nuk janë, as e kanë në thelbin e fesë së tyre. Ai kërkoi nga të pranishmit që ta ruajnë me dinjitet fenë e tyre, ta dëshmojnë Islamin me vepra dhe mos të pranojnë nga askush, për asnjë arsye, nënçmimin e Islamit dhe etiketimin e tij me vulgaritetet e papranueshme, që dëgjojnë sot.

Aktiviteti vijoi me këndimin e ilahive dhe pjesëve të Mevludit të H. Ali Ulqinakut, shoqëruar me salavate dhe lutje të përbashkëta për të mirën e komunitetit, Shkodrës, Shqipërisë e mbarë ymnetit islam.

TUBIM ME VLERA BESIMI NË XHAMINË E TRUSHIT



MYFTINIA SHKODËR, KONTRIBUT FAMILJES HOXHA PAS DJEGIES SË SHTËPIVE

Pasditën e së enjtes, më 13 prill 2017 përfaqësues të Myftinisë Shkodër vizituan familjarët, të cilëve u janë djegur shtëpitë dhe i dorëzuan kontributin e mbledhur nëpër xhamitë e Shkodrës, vëllezërve Hoxha, të cilët patën fatkeqësi në djegien e shtëpive të tyre, pas një zjarri që i përfshiu.

H. Fejzi Zaganjori, imam i xhamisë së Rusit dhe Lavdrim Hamja, i dorëzuan në emër të Myftinisë Shkodër kontributin e mbledhur prej bamirësisë së besimtarëve të xhamive të qytetit, por jo vetëm. Të dy imamët i transmetuan vëllezërve Hoxha, në emër të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari dhe gjithë besimtarëve të Shkodrës selamet dhe lutjet e tyre, që Zoti i Madhuar t'i ndihmojë dhe tu bëhet mbështetje në kapërcimin e kësaj fatkeqësie.

Vëllezërit Xhelal, Ruzhdi, Merzuk



Hoxha dhe bashkëshortja e të ndjerit Haki Hoxha falënderuan nga ana e tyre të gjithë ata, që kanë kontribuar dhe u janë gjetur pranë në këto momente të vështira, ku shtëpitë e tyre u përfshinë nga flakët dhe shkumbuan çdo gjë që posedonin.

Myftinia Shkodër u bën thirrje gjithë

qytetarëve të Shkodrës, që të vazhdojnë të kontribuojnë për këto familje në përballimin e fatkeqësisë së tyre dhe njëkohësisht lutemi, që Zoti i Madhëruar tu japë ndihmën dhe mbarësinë e tij në mbështetje të këtyre familjarëve, për tu kthyer sa më parë në shtëpitë e tyre.

MYFTIU: “TË ZHVILLOJMË NJË TUBIM LUTJEJE, PËR SHËRIMIN E ISLAMOFOBËVE NË TROJET SHQIPTARE!”



Ditën e shtunë, më 15 prill 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me një grup imamësh, me të cilët diskutoi rreth disa tematikave, që sillen rreth aktivitetit të Myftinisë Shkodër dhe domosdoshmërisë së rritjes së cilësisë së tij.

Ndër të tjera, Myftiu u ndal tek disa pika, ku veçohet:

1. Domosdoshmëria e ruajtjes së vlerave të harmonisë në komunitet dhe distancimi total nga çdo tendencë për të keqinterpretuar a keqlexuar tekstet fetare, si dhe për të mbjellur përçarje në mesin e besimtarëve, duke shërbyer me shumë përkushtim në rrugën e përhapjes së vlerave të edukimit islam, me dije, urtësi e durim.

2. Përgatitjet për muajin Ramazan, duke nisur me shtimin e tubimeve pas namazeve ditore, kryesisht: pas namazit të sabahut dhe atij të akshamit, por edhe pas namazeve të tjera ditore, sipas mundësisë dhe dakortësisë me xhematin.

3. Përgatitja për zhvillimin e bashkëbisedimeve me rininë, sidomos në atmosferën e Tre Muajve të Mirë, ku është e dobishme të diskutohen tema të tilla, si: Rëndësia e namazit në jetën e besimtarit, Shfrytëzimi i Muajve të Mirë për shtimin e dhikreve, salavateve, hatmeve të Kur'anit, lutjeve në bashkësi, Angazhimi për ta nxjerrë frymën e këtyre Muajve të Mirë,

përtej mureve të xhamisë, nëpërmjet vizitave, afrimin e rinisë dhe fëmijëve, agjërimit e përbashkëta, ekskursioneve në natyrë etj.

4. Çlirimi nga krejt paranojat e kujtdo, që na ngatërron në muslimanëve, xhamitë tona, simbolet tona fetare, aktivitetet tona, kërkesat tona legjitime, veprimtarinë tonë dhe kontributet e vazhdueshme për ruajtjen e ekuilibrit të harmonisë komunitare, me terma e shpifje të padenja për këtë tubim vlerash; terma e shpifje që ia kthejmë mbrapsht kujtdo, me plot të drejtë dhe me shumë përbuzje ndaj nivelit të lartë të injorancës dhe meskinitetit!

Në këtë pikë, Myftiu theksoi se: “Nuk është utopike, që në një ditë të caktuar, të zhvillojmë një tubim lutjeje Zotit, për shërimin e islamofobëve në trojet shqiptare, si dhe të nënshkruhet një peticion drejtuar institucioneve zyrtare të vendit dhe mediave, që të mos lejohet ky vulgaritet mjerran, që ka përfshirë deri parlamentin dhe ministri të ndryshme, prej ku persona të papërgjegjshëm të veshur me pushtet të përkohshëm, përhapin vnerin e islamofobisë dhe osmanofobisë në realitetet shqiptare!”

U lajmërua gjithashtu edhe për konkursin e madh vjetor me nxënësit e kurseve të xhamive të Shkodrës, sipas udhëzimeve të përgjegjësit të arsimit.



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

*“Nuk ka besuar
asnjëri prej jush,
derisa të dojë
për vëllanë e tij,
atë që do për
veten e tij”*

MYFTIU: “TË LUTEMI PËR MBARËSINË DHE SUKSESIN E REFERENDUMIT TË 16 PRILLIT NË TURQI!”

Ditën e shtunë, më 15 prill 2017, gjatë një takimi pune me imamë të Shkodrës, Myftiu Imam Muhamed B. Sytari, është ndalur edhe tek një çështje që shihet sot, me shumë vëmendje nga mbarë ymmeti islam, ajo e referendumi të datës 16 prill 2017 në Turqi.

Ndër të tjera, Myftiu tha: “Në kuadër të hadithit: “Nuk ka besuar asnjëri prej jush, derisa të dojë për vëllanë e tij, atë që do për veten e tij”, si pjesë integrale e këtij ymmeti të bekuar islam. lutemi me zemër, që votimi i ditës së dielë, më 16 prill 2017 në Republikën e Turqisë, që konsiderohet si fillimi i një ndryshim historik për Turqinë e Presidentit Rexhep Erdogan, të shkojë mbarë e mirë dhe me sukses të plotë, në rrugën e konsolidimit të mëtejshëm të pozitave të shtetit, ku jetojnë edhe miliona shqiptarë, në një mirëqenie



përherë e në rritje dhe që konsiderohet nga elitat e ymmetit islam, si boshti kryesor i mbarë botës islame, sot!”

Myftiu theksoi, se angazhimi për të të lexuar zhvillimet e politikës dhe lëvizjet e dinamikës së botës islame,

është një urdhëresë kur'anore dhe porosi e Hz. Muhamedit (a.s), që nuk duhet ta neglizhojmë as ta hedhim pas krahëve, në rrugëtimet e rizgimit dhe rimekëmbjes së madhe të muslimanëve në këtë shekull!

MYFTIU UROI DREJTUESIT E DY KOMUNITETEVE TË KRISHTERA TË QYTETIT

Ditën e dielë, më 16 prill 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, me bashkëpunëtorë, zhvilloi vizitat tradicionale në Kishën Ortodokse dhe në Famullinë Katolike të Shkodrës, me rastin e festës së Pashkës, si një ditë e shënuar për besimtarët e krishterë kudo në botë.

Urimet për besimtarët e krishterë, Myftiu i ndau me drejtuesit e komunitetit ortodoks dhe atij katolik; At Aleksandër Petani dhe Mons. Angjelo Massafra, me të cilët zhvilloi edhe një bashkëbisedim mbi realitetet e sotme të vendit dhe botës, si dhe domosdoshmërinë e paqimit të njeriut me Zotin dhe shtimin e dashamirësisë së njeriut për vëllanë e tij njeri.

Në mesazhet e tij, Myftiu theksoi se ruajtja e ekuilibrave të harmonisë fetare, si vlerë e rëndësishme kombëtare, si dhe angazhimi për forcimin e paqes sociale, kërkon maturi dhe ruajtje nga përpjekjet për prishjen e këtyre ekuilibrave.

Ai tha se, ne duhe të ndahemi nga vulgu i nxitjes së urrejtjes fetare, që disa e kanë ndërmarrë si mision, duke mbjellur përcarje në mesin e shqiptarëve, si dhe duke nxitur mosrespektimin e besimit dhe simboleve të tij.

Njëkohësisht, Myftiu theksoi se



organizimi i një marshimi publik në mesin e besimtarëve të feve të ndryshme, deklaratat, aktivitetet e përbashkëta

etj, janë mundësi për të nxjerrë në pah angazhimet tona të sinqerta drejt rrugëve të paqes, harmonisë dhe ruajtjes së tyre.

MYFTIU PRITI THIRRËSIN ISLAM SHQIPTAR NË SHBA, Z. BURHAN FILI

Ditën e hënë, më 17 prill 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzmërt thirrësin islam shqiptar me banim në ShBA, z. Burhan Fili.

Gjatë këtij takimi të ngrohtë, dy bashkëbiseduesit këmbyen mendime rreth aktualitetit të Thirrjes Islame në Shkodër dhe Shqipëri, si dhe rreth zhvillimeve të reja të botës islame.

Z. Burhan Fili, dha disa këshilla të urta prindërore, nëpërmjet të cilave kërkoi që brezi i ri i hoxhallarëve të vendit tonë duhet ta shtojnë aktivitetin dhe të kërkojnë më të mirën në shërbim të interesit fetar dhe atij kombëtar.

Ai u lut që Myftinia Shkodër të ketë përherë mbarësi dhe aktivitet të dobishëm, sikurse vuri theksin te domosdoshmëria e bashkëpunimit në mesin e imamëve dhe teologëve të rinj



në dobi të Islamit dhe masës së gjerë.

Ai e lajmëroi Myftiun për botimin e një novele të re në gjuhën angleze, si dhe botimin e saj edhe në shqip. Me këtë rast, Myftiu e ftoi të nderuarin,

z. Burhan Fili, që ky botim i ri të prezantohet edhe në Shkodër, si dhe të promovohet në një tubim të veçantë në mesin e intelektualëve dhe besimtarëve të Shkodrës.

MYFTIU PRITI IMAMIN E B.I.SHQIPTARE “MËRGIMI”, ZVICËR

Paraditen e së xhumasë, më 21 prill 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzmërt e vëllazëror, z. Festim Miftari, imam i Qendrës Islame Shqiptare “Mërgimi”, në Affoltern am Albis, Zvicër.

Gjatë këtij takimi, Myftiu e njohu mikun e tij me aktivitetin dhe sfidat e Myftinisë Shkodër, sikurse e prezantoi me disa prej botimeve të saj ndër vite. Nga ana e tij, z. Festim Miftari falënderoi Myftiun për mikpritjen duke theksuar se emri i Myftinisë Shkodër është një emër që përmendet për vlerat dhe aktivitetin e vazhdueshëm, si dhe si një model për t'u ndjekur në rrugën e shërbimeve ndaj Thirrjes Islame.

Myftiu dhe imami i Qendrës Islame Shqiptare “Mërgimi”, falën së bashku namazin e xhumasë në xhaminë e Plumbit, me ç'rast, imami i nderuar drejtoi faljen e namazit të xhuma. Më pas, z. Festim Miftari zhvilloi edhe një intervistë për emisionin e përjavshëm të Myftinisë Shkodër në Radio “Jehona”: “Ora e xhumasë”, ku foli për aktivitetin e xhamisë “Mërgimi”, për muslimanët shqiptarë në Zvicër dhe përhapjen e Islamit atje etj.



XHAMITË E SHKODRËS, PËRKUJTOHET ISRAJA DHE MIRAXHI



Me udhëzim të posaçëm të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ditën e xhuma, më 21 prill 2017, në të gjitha xhamitë e Shkodrës, hytbeja e kësaj jave iu kushtua ndodhisë së mrekullueshme të Israsë dhe Miraxhit të Hz. Muhamedit (a.s), nga Meka në Kudsi Sherifë dhe prej aty, drejt lartësive qiellore.

Israja dhe Miraxhi është një ndër ngjarjet më të shënuara në jetën e të Dërguarit të All-llahut, për të cilën bëjnë fjalë edhe ajete të shumta në suren "El-Isra" dhe në suren "En-Nexhm".

Imamët e xhamive të Shkodrës, kanë bërë thirrje sot, që muslimanët të lexojnë me vëmendje detajet e kësaj ngjarjeje të shënuar, për të kuptuar se Islami është feja që e merr për dore njeriun për ta nxjerrë nga errësira në dritë, nga padituria në dije, nga dobësia në forcë, nga egoizmi në altruizëm, nga arroganca në mëshirë.

Israja dhe Miraxhi janë një ftesë për të mos jetuar në poshtërim, sikurse nxisin muslimanët kudo në botë drejt lartësimit në këtë botë dhe angazhimit për përhapjen e vlerave më të mira të paqes dhe drejtësisë në jetë.



All-llahu (xh.sh)
thotë në Kur'an:

“Pa të meta
është Lartmadhëria
e Atij që robin e Vet e
kaloi në një pjesë
të natës prej
Mesxhidi Haramit
gjer në Mesxhidi Aksa,
rrethinën e të cilës Ne e
kemi bekuar,
për t’ia treguar atij disa
nga argumentet Tona.
Vërtet, Ai është
Dëgjuesi, Shikuesi.”
(Kur'ani, El-Isra: 1)

ZBULOHET NJË DORËSHKRIM I RI NGA HAFIZ YMER BAKALLI


Nëpërmjet një postimi në profilin e tij në fb, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ka lajmëruar ditën e djeshme, më 20.4.2017, se ka zbuluar një dorëshkrim të ri me autor dijetarin e shquar shkodran, Hafiz Ymer Bakalli (1880-1953).

Në vijim, postimi i bërë nga Myftiu me këtë rast:

“Sonte përjetova një emocion të papërshkrueshëm, teksa zbulova një dorëshkrim origjinal, me autor dijetarin e shquar shkodran, Hafiz Ymer Bakalli, rahmet pastë.

Materiali në fjalë, (për të cilin nuk do të flas me hollësi tani), ka një vlerë të madhe në trajtimin e pozitës së sahabëve në Islam dhe distancimin nga etiketimet fanatike dhe injorante në hak të tyre, është shkruar me dorën e Hoxhës së ditur në fletë të bardha, me stilograf me ngjyrë të zezë, është i qepur në mes dhe ka dy kopertina të trasha me zbukurime orientale.

Dorëshkrimi është ndarë në dy tema, të cilat autori i trajton paralelisht, të ndara nga njëra-tjetra, brenda secilës faqe. Pra, kemi të bëjmë me dy trajtesa rreth



një teme, në një dorëshkrim të vetëm.

E krahasova shkrimin e tij me disa dorëshkrime të tjera të zotërisë së tij dhe dola në përfundimin e autenticitetit të tij, pavarësisht shënimeve përforcuese, si vijon:

- Në faqen e parë të dorëshkrimit, shënon: “E grumbulluesit të tij, të varfërit, të përulurit, nevojtar për mirësitë e Zotit të tij të Plotfuqishëm, Omeri (Ymer), i biri i Ed’hem (Et’hem) shkodranit, Zoti e faltë”.

- Në përfundim të dorëshkrimit, autori shënon: “All-llahumme na bëj të

kapemi pas shariatit muhammedi dhe prej atyre që pasojnë traditat e të Dërguarit, që të fitojmë nëpërmjet tyre gradët e larta dhe të meritojmë nëpërmjet tyre ndërmjetësimin e tij (shëfatin), All-llahu e begatofte atë, familjen e tij të respektuar dhe shokët e tij të nderuar, të cilët e pasuan atë në çdo gjendje e situatë.

U përfundua shkrimi

i tij (i këtij libri –M.S.-) në muajin, në të cilin u lind Zotëria i njerëzisë, Muhammedi (a.s), nga muajt e vitit 1341 nga hixhreti i atij që është rrethuar me nder e krenari.

Ndërsa unë jam i varfëri, i huaji (el-garib), duarboshi (adimel-bidaati), i pamunduri Omeri, i biri i Ed’hem shkodranit, i faltë të dy Mbreti i Plotpushtetshëm...”

Pra, bëhet fjalë për një dorëshkrim 97 vjeçar nga njëri prej hoxhallarëve të shquar të Shkodrës, elhamdulillah!”

MYFTIU I SHKODRËS DËNON SULMET MBI KISHAT KOPTË NË EGJIPT




botën nga idhujtaria e djajve, armiqve të Humanizmit, pa dallim feje, race, kombësie!

Dënoj me zemër këtë veprim të ulët dhe çnjerëzor, me të njëjtin zemërim, që kam dënuar dhe dënoj shkatërrimin e objekteve të adhurimit a lëndimin e besimtarëve të cilësdo fé në botë!

Sepse në fund të fundit, njeriu është vëlla i njeriut, ndërsa e drejta e besimit dhe përzgjedhjeve në jetë, është çështje personale, për të cilën, njeriu, llogarinë e tij e ka me Zotin, jo me robin; musliman, i krishterë, a çfarëdo qoftë!

Kushdo që prek vendadhurimet dhe vret besimtarë të pafajshëm, është armik i Zotit, armik i Njerëzimit!”

XHAMIA "EBU BEKËR"
FUSHË ÇELË, SHKODËR



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org